



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:012735  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05496121

C.nr.151/2023

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari Shyqri Hoxha, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në kontestin e paditësit B.Sh. me numër personal .... nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson B.M. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës S.P. "Prim. Dr. Daut Mustafa" me seli në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson B.L. për shkak të vërtetimit se është shkelur e drejta e punës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor-publik, në prezencë të të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datën 29 janar 2024, mori, ndërsa me datë 18 mars 2024, përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesëpadija e paditësit B.Sh. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të *"VËRTETOHET se paditësi B.Sh. nga Prizreni, i është shkelur e drejta e punës nga e paditura S.P. "Prim. Dr. Daut Mustafa", në Prizren dhe se të njëjtit i takon e drejta e pezullimit të përkohshëm të punës. DETYROHET e paditura S.P. "Prim. Dr. Daut Mustafa", në Prizren, që të zbatohet këtë vendim në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm."*
- II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi B.Sh. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij B.M. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datën 16.01.2023, ka paraqitur padi, ndaj të paditurës S.P."Prim. Dr. Daut Mustafa" me seli në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson B.L. për shkak të vërtetimit se është shkelur e drejta e punës.

I autorizuari i paditësit, në padinë e paraqitur, ka theksuar se paditësi me datë 10.02.2022, pranë të paditurës ka paraqitur kërkesën me nr.2/19, për pezullimin e përkohshëm nga puna, ndërsa e paditura me përgjigjen e datës 18.02.2022, ia ka refuzuar kërkesën e paditësit. Paditësi me datë 19.02.2022, ka paraqitur ankesë pranë Inspektoratit të Punës, kundër vendimit për refuzim të pezullimit të marrëdhënies së punës në Spitalin e Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren. Inspektorati i Punës, me datë 22.02.2022, ka nxjerrë vendimin me r.47/2022, me të cilin është aprovuar ankesa e paditësit dhe është urdhëruar e paditura, që të bëjë pezullimin e marrëdhënies së punës së paditësit. Ndërsa me venin me numër 743, të datës 04.11.2022, Inspektorati i Punës, e ka aprovuar ankesën e të paditurës dhe e ka anuluar Vendimin Nr.47/2022, të datës 22.02.2022, të lëshuar nga Inspektorati i Punës në Prizren. Tutje ka shtuar se Inspektorati i Punës, gabimisht e ka interpretuar nenin 41 të Ligjit të Punës, pasi që nuk qëndrojnë asnjë nga pretendimet të cilat Inspektorati i ka përmendur në vendimin e tij. sipas të njëjtit nga interpretimi i kësaj dispozite shumë qartë mund të kuptojmë që kjo dispozitë vlen edhe në rastet e emërimeve si dhe për rastet e zgjedhjeve të funksionarëve publik, siç është rasti i emërimit si kryeshef ekzekutiv i paditësit, sepse nga rrjedha logjike e Ligjit për Ndërmarrjen Publike kuptohet që edhe në rastet e shpalljeve të konkurseve procedura përfundon me emërim të zyrtarit të pranuar. Ndërsa Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, në nenin 3 par.2.3, ka paraparë që funksionarët publik janë funksionarë të emëruar nga Kuvendi apo Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe agjencive të pavarura. Në asnjë dispozitë ligjore nuk ceket që në rastet e konkursit publik, nuk vlen neni 41 i Ligjit të Punës, ku është pikërisht Inspektorati i Punës që në vendimin e tij, ka bërë aplikim të gabuar të të drejtës material, sepse vendimin e tij e ka bazuar në nenin 22 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pasi që paditësi para se të emërohet Kryeshef ekzekutiv i "Eko-Regjionit" ka qenë me status të shërbyesit publik dhe jo zyrtar publik. Po ashtu nuk është arritur të kuptohet se funksionarët publik dhe zyrtarët publik nuk janë kategori e njëjtë dhe nuk rregullohen me të njëjtin ligj. Fakti se vendimi është i padrejtë dhe i pabazuar, kuptohet edhe nga konstatimi i Inspektoratit të Punës, të cilët në vendimin e tyre vazhdimisht konstatojnë se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës apo për Organet Komunale, duke treguar që sipas tyre funksionarë publik janë vetëm personat të cilët mbajnë këto pozita politike, mirëpo funksionarë publik janë edhe personat të cilët mbajnë pozita tjera përveç pozitave politike, siç është rasti me këtu paditësin B.Sh. Me datë 24.11.2022, paditësi i është drejtuar të paditurës me kërkesë për pezullimin e procedurës, ndërsa me njoftimin Nr.11/24, të datës 20.12.2022, nga e paditura është refuzuar kërkesa për pezullimin e procedurës. Në fund gjykatës i ka propozuar që të marrë vendim dhe padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovon në tërësi si të bazuar.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i paditësit, ka deklaruar se qëndron në tërësi si në padi, ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim i autorizuari i paditësit ka theksuar se qëndron në tërësi pranë pretendimeve të paraqitura në padi

dhe në deklaratimet në seancat paraprake dhe i propozon gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit. Konsideron se pretendimet e palës së paditur janë të pa bazuara dhe i kundërshton në tërësi, për faktin se të njëjtit i takon e drejta për pezullim të përkohshëm nga marrëdhënia e punës. Paditësit i janë shkelur të drejtat të cilat rrjedhin nga neni 41 të Ligjit të Punës, ku nga kjo dispozite parashihet se të punësuarit mund ti pushojnë të drejtat nga marrëdhënia e punës për një kohe të caktuar, në rast se zgjedhet apo emërohet në funksione publike. Funksionet publike kane për qëllim mbrojtjen e interesit të përgjithshëm, mirëpo mund të ndodhë që ndalojnë se ushtruari këtë funksion dhe një i punësuar të mbetet pa pune dhe me qëllim që njerëzve që ju besohet funksione publike të kenë siguri juridike dhe të mos hezitojnë në ushtrimin e këtij funksioni është paraparë kjo e drejtë ligjore për obligim ligjor për punëdhënësin. Në rastin konkret është bërë interpretim i gabuar të drejtës materiale, ngase vendimi është bazuar në nenin 22 të Ligjit për Zyrtaret Publik, ngase si funksionarë publikë janë edhe personat që mbajnë pozita të tjera përveç pozitive politike siç është rasti i paditësit. Ndërsa në Ligjin për Zyrtaret Publike, në nenin 3 par. 2.3 ka parapare që funksionarë publik janë funksionaret e emëruar nga Kuvendi apo Presidenti i Republikës së Kosovës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të pavarura dhe agjencive të pavarura. Pra nga kjo dispozite e ligjit mund të kuptojmë që funksionarë publikë janë edhe drejtuesit e institucioneve të pavarura dhe agjencive të pavarura. Në këtë rast "Eko-Regjioni" e cila është ndërmarrje e themeluar nga Kuvendi Komunal në Prizren, mirëpo veprimtarinë e saj e shfrytëzon në mënyrë të pavarur, ndërsa në mënyrë të pavarur bëhet edhe emërimi i zyrtarëve publikë. Nga kjo mund të vërejmë se kjo dispozite ligjore, vlen edhe në rastet e emërimeve si dhe për rastet e zgjedhjeve të funksionareve publike, siç ishte edhe rasti i emërimit si kryeshef ekzekutiv i paditësit, sepse nga rrjedha logjike e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nënkuptohet që edhe rastet e shpalljes së konkurseve, procedura përfundon me emërim të zyrtarit të pranuar. Nga kjo rrjedh se paditësit i janë shkelur të drejtat e tij, pasi që të njëjtit i ju është refuzuar kërkesa për pezullim të përkohshëm nga vendi i punës vetëm me një përgjigje në kërkesë e cila nuk përmban asnjë nga elementet kryesore të një akti administrativ. Paditësi para se të emërohet kryeshef ekzekutiv, ka qene me status të shërbyesit civil jo të zyrtarit publik, andaj kjo e drejtë i takon në bazë të nenit 89 të Ligjit për Shërbyesit Civil, ku nga kjo dispozite rrjedh se pas mbarimit të pezullimit të dakorduar, nëpunësi civil ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme. Meqenëse paditësi nuk ka qenë asnjëherë zyrtarë publik në Spitalin Regjional të Prizrenit dhe meqenëse si kryeshef ekzekutiv nuk vepron në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë, atëherë i bie që Inspektorati i punës, vendimin e tij e ka mbështetur në një dispozitë e cila nuk është fare e zbatueshme në rastin konkret. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovon në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar, ashtu si i ka specifikuar në fjalën përfundimtare.

E paditura S.R. "Prim. Dr. Daut Mustafa" me seli në Prizren, në përgjigjen në padi të datës 25.09.2023, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se kuptimi dhe fryma e përcaktimit ligjor për pezullimin e përkohshëm lidhet me zgjedhjen dhe emërimin në pozita që dalin nga procesi elektorale apo që emërohen në pozita të caktuara përmes disa institucioneve apo organeve dhe jo që dalin si konsekuencë e konkursit publik. Në këtë rast nuk lejohet pezullimi i punës për arsye se pozita e re është pozitë për të cilën duhet të hapet konkursi publik dhe rrjedhimisht të zhvillohet garë e hapur për të. Pezullimi i përkohshëm i marrëdhënies së punës në pozitën e rangut më të ulët në një Institucion Publik, për të marrë një pozitë të një rangu më të lartë në një institucion tjetër publik, pozita këto që rezultojnë si efekt i përzgjedhjes profesionale përmes procedurës së hapur të konkurrimit publik, nuk bien në domenin dhe frymën e nenit 40 par.1, nën par.1.2 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës. Si analogji me këtë mund të merret edhe Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ligj ky i cili rregullon marrëdhënien e punës të nëpunësve civil, të përcaktuar qysh me nenin 2 të tij. Me këtë ligj zgjedhja dhe emërimi reflektohen gjithmonë me proceset elektorale apo emërimin në pozitë politike dhe kurrsesi nuk referohet për pozita që merren si efekt i konkursit publik dhe që për të njëjtat kërkohen kritere specifike siç janë kualifikimi, përvoja e punës, etj. Në fund i autorizuari i të paditurës, gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, përfaqësuesi i të paditurës ka qëndruar në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke e kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, ka theksuar se Kuptimi dhe fryma e përcaktimit ligjor për pezullimin e përkohshëm të vendit të punës lidhet me zgjedhjen ose emërimin në pozita që dalin nga procesi elektorale apo emërohen në pozita të caktuara përmes disa institucioneve apo organeve, dhe jo që dalin si konsekuencë e konkursit publik. Pozita e re është pozitë për të cilën hapet konkurs publik, dhe rrjedhimisht zhvillohet garë e hapur për të. Prandaj kjo pozite është vend pune përmes konkursit publik, siç është vend pune edhe pozita e zyrtarit në rangun më të ulët. Pezullimi i përkohshëm i marrëdhënies së punës në pozitën e një rangu më të ulët në një institucion, për të marrë një pozitë të një rangu më të lartë në një institucion tjetër publik, pozita këto që rezultojnë si efekt i përzgjedhjes profesionale përmes procedurës së hapur të konkurrimit publik, nuk bien në domenin dhe frymën e nenit 41 paragrafi I, nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, i cili përcakton që: 1.2 Kur zgjidhet apo emërohet në funksione publike. Andaj gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovon në tërësi si të bazuar, ndërsa vendimi i Inspektoratit të Punës, i shkallës së dytë i datës 04.11.2022, të mbetet në fuqi.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

## 2. Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: kërkesën e paditësit për pezullim të përkohshëm nga puna, të datës 10.02.2022, drejtuar Këshillit Drejtues të Spitalit të Përgjithshëm në Prizren; njoftimin e datës 06.06.2022, nga ana e të paditurës; përgjigjen në kërkesë me nr. 2/19, të datës 18.02.2022, të drejtuar nga zyrtari ligjor i të paditurës; ankesën e paditësi drejtuar Inspektoratit të Punës, të datës 19.02.2022; vendimin e Inspektoratit të Punës, me nr. 47/22, të datës 22.02.2022; vendimin e Inspektoratit të Punës me nr. të protokollit 743, të datës 04.11.2022; vendimin me nr. 20, të datës 28.01.2021, të nxjerr nga Oda Ekonomike e Kosovës për B.F. nga Gjakova; vendimin me nr. 01-07/794, të datës 21.06.2021, të nxjerr nga KRM EKO Regjioni sh.a., Prizren; kontratën për kohë të pacaktuar, me nr. 1356, të datës 02.05.2019; kërkesën për pezullim të procedurës të drejtuar nga i autorizuari i palës paditëse për të paditurën, me datë 23.11.2022; njoftimin me nr. të prot.11/24, të datës 15.12.2022, të lëshuar nga e paditura.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se: kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Nga leximi i kërkesës së paditësit për pezullim të përkohshëm nga puna, të datës 10.02.2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.Sh. Zyrtar Ligjor në Spitalin e Përgjithshëm, i kishte drejtuar Këshillit Drejtues të Spitalit të Përgjithshëm në Prizren, me kërkesë për pezullimin e përkohshëm të punës, duke u bazuar në Ligjin e Punës, Ligji Nr. 03/L-212, neni 41, paragraf 1.2, me arsyetimin se është emëruar në një funksion të lartë publik me mandat tre vjeçar Drejtor Ekzekutiv dhe pas skadimit të këtij mandati të kthehet në vendin e punës të cilin e ka në Spitalin e Përgjithshëm.

Nga leximi i njoftimit të datës 06.06.2022, nga ana e të paditurës lidhur me kërkesën për pezullim, gjykata vërtetoi faktin se Kërkesa ishte shqyrtuar në Këshillin Drejtues, është dërguar në Zyrën Ligjore. Zyra Ligjore ka dhënë përgjigjen me nr.6/7, të datës 18.02.2022, duke e refuzuar kërkesën për pezullim. Pas kësaj parashtruesi i kërkesës B.Sh. ka bërë ankesë në Inspektoratin e Punës, i cili me vendimin nr.47/2022, e ka aprovuar ankesën e B.Sh. si të bazuar. Me datë 28.02.2022, Spitali i Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren ka bërë ankesë në shkallën e dytë të Inspektoratit të Punës, duke njoftuar se Vendimi për pezullim ose ndërprerje të marrëdhënies së punës do të merret pas vendimit të Shkallës së Dytë të Inspektoratit të Punës.

Nga leximi i përgjigjes në kërkesë me nr. 2/19, të datës 18.02.2022, të drejtuar nga zyrtari ligjor i të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se e paditura e kishte lajmëruar këtu paditësin se në rastin e tij nuk lejohet pezullimi i pozitës. Duke theksuar se kuptimi dhe fryma e përcaktimit ligjor për pezullimin e përkohshëm lidhet me zgjedhjen ose emërimin në pozita që dalin nga procesi elektoral apo që emërohen në

pozita të caktuara përmes disa institucioneve apo organeve dhe jo që dalin si konsekuencë e konkursit publik. Si analogji për këtë mund të merret edhe Ligji Nr.06/L-114, për Zyrtarët Publik, ligj ky i cili rregullon marrëdhënien e punës të nëpunësve publik.

Nga leximi i ankesës së paditësi drejtuar Inspektoratit të Punës, të datës 19.02.2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësi kishte parashtruar ankesë nda përgjigjes me numër 6/7, të datës 18.02.2022, me të cilën ishte refuzuar kërkesa e tij për pezullimin e përkohshëm të vendit të punës pran të paditurës.

Nga leximi i vendimit të Inspektoratit të Punës, me Nr. 47/22, të datës 22.02.2022, gjykata vërtetoi faktin se ishte aprovuar ankesa e palës, këtu paditësit B.Sh. me numër 268, e datës 18.02.2022, si e bazuar dhe është urdhëruar e paditura Spitali Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren, që të bëj pezullimin e përkohshëm të pozitës Zyrtar Ligjor në Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren deri në skadimin e pozitës Kryeshf Ekzekutiv i K.r.M "Ekoregjion" Sh. A, me datë 21.06.2024.

Nga leximi i vendimit të Inspektoratit të Punës, me nr. të protokollit 743, të datës 04.11.2022, gjykata vërtetoi faktin se Organi i Shkallës së Dytë në Inspektoratin e Punës, kishin vendosur sipas ankesës së paraqitur nga përfaqësuesja e të paditurës Spitali i përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren dhe është aprovuar si e bazuar ankesa e të paditurës, ndërsa është anuluar Vendimi Nr.47/2022, i datës 22.02.2022, i lëshuar nga organi i shkallës së parë të Inspektorit të Punës në Prizren.

Nga leximi i vendimit me nr. 01-07/794, të datës 21.06.2021, të nxjerr nga Kompania Regjionale për Mbeturina "Ekoregjioni" Sh. A, në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se Bordi i Drejtorëve pranë kësaj kompanie, në cilësinë e Komisionit Përzgjedhës, sipas konkursit për pozitën Kryeshf Ekzekutiv, pas përfundimit të procesit rekrutues, kishte marrë vendim dhe Kryeshf Ekzekutiv i K.R.M. "Ekoregjioni" Sh. A, ishte përzgjedhë B.Sh. I njëjti do të kryen detyrat konform autorizimeve në pozitën e Kryeshfeit Ekzekutiv, duke filluar nga data 22.06.2021, mandat i cili do të zgjat deri me datë 21.06.2024.

Nga leximi i kontratës për kohë të pacaktuar, me numër 1356, të datës 02.05.2019, gjykata vërtetoi faktin se këtu paditësi B.Sh. ka krijuar marrëdhënie pune pranë të paditurës Spitali i Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren, në pozitën Zyrtar Ligjor.

Nga leximi i kërkesës për pezullim të procedurës të datës 23.11.2022, gjykata vërtetoi faktin se i autorizuari i këtu paditësit i ishte drejtuar të paditurës Spitali i Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren, Drejtorit të Administratës, me propozim që e paditura bazuar në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, të aprovon

kërkesën e paditësit dhe të Pezullohet Procedura në çështjen juridike të palës-paditësit B.Sh. deri në vendosjen definitive të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, sipas padisë së paraqitur me datë 23.11.2022, për anulimin e vendimit IP.nr.743, të datës 04.11.2022.

Nga leximi i njoftimit me nr. të prot.11/24, të datës 15.12.2022, të lëshuar nga e paditura, gjykata vërtetoi faktin se Drejtori i Administratës pranë të paditurës, e kishte njoftuar këtu paditësin se pas marrjes së opinionit ligjor nga Zyra Ligjore e Spitalit të Prizrenit, kërkesa e tij për pezullimin e procedurës nuk aprovohet. Të njëjtit kanë theksuar se çfarëdo vendimi të merr Gjykata Themelore, Departamenti për Çështje Administrative, që do të vendoset në rastin e këtu paditësit të njëjtit do ta zbatojnë.

### 3. Baza ligjore

Gjykata vlerëson se në këtë çështje juridike kontestimore gjen zbatim Ligji Nr.06/L-114, për Zyrтарët Publik, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi pretendon se nga ana e të paditurës i janë shkelur të drejtat.

Me Ligjin Nr. 06/L-114, për Zyrтарët Publik,, në nenin 2, është përcaktuar se kush janë Zyrтарët Publik, përkatësisht në paragrafin 2, të këtij neni, është përcaktuar se: *“Zyrтарë publikë janë: 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik;..”*, ndërsa në paragrafin 4 të këtij neni është përcaktuar se: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtëpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike”*. Ndërsa në nenin 22 të ligjit të lartcekur është përcaktuar se kur munden zyrтарët publik të pezullojnë vendin e punës së tyre, përkatësisht në paragrafi 1, të këtij neni është paraparë se: *“Zyrтарët publikë, të cilët kandidojnë për zgjedhjet qendrore ose lokale, duhet të pezullojnë vendin e punës shtatë (7) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës. Pezullimi përfundon pesë (5) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës”*, ndërsa në paragrafin 6, të nenit të lart cekur, është paraparë se: *“Në rast të zgjedhjes në Kuvendin e Republikës së Kosovës, zyrтарi publik, i cili pranon mandatin, pezullon marrëdhënien e punës prej datës së certifikimit të zgjedhjes së kandidatit deri në përfundim të mandatit përkatës, në pozitë ekuivalente”*, paragrafi 7, ka përcaktuar se: *“Në rast të zgjedhjes në organet komunale, nëpunësi civil i komunës, ku ai punon dhe i cili pranon mandatin, pezullon marrëdhënien e punës prej datës së certifikimit të zgjedhjes së kandidatit deri në përfundim të mandatit përkatës”*, ndërsa në paragrafin 8, është përcaktuar se: *“Pas përfundimit të mandatit të zgjedhur, zyrтарit publik i garantohet marrëdhënia e punës në institucionin ku ka qenë në marrëdhënie pune, në pajtim me përgatitjen profesionale të tij/saj”*.

### 4. Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Nga provat e administruara dhe në bazë të fakteve të vërtetuara, gjykata gjeti se nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune pranë të paditurës Spitali i Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren, në vendin e punës Zyrtar Ligjor dhe se i njëjti i është të drejtuar të paditurës me kërkesë për pezullimin e përkohshëm nga puna, pasi që është emëruar në një funksion të lartë publik me mandat tre vjeçar-Drejtor Ekzekutiv në Ndërmarrje Publike, ndërsa kjo kërkesë i është refuzuar me përgjigjen e datës 18.02.2022. Po ashtu, nuk ishte kontestuese se fillimisht me vendimin e datës 22.02.2022, të Inspektoratit të Punës, ishte aprovuar ankesa e këtui paditësit dhe ishte urdhëruar e paditura që të bëjë pezullimin e përkohshëm të pozitës zyrtar ligjor të këtui paditësit, ndërsa me vendimin e Shkallës së Dytë të Inspektoratit të Punës, të datës 04.11.2022, ishte aprovuar ankesa e të paditurës, ndërsa ishte anuluar vendimi Nr.47/2022, i datës 22.02.2022, i lëshuar nga shkalla e parë. Kontestuese ishte fakti nëse e paditura me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit për pezullimin e përkohshëm të marrëdhënies së punës, i ka shkelur të drejtat e paditësit B.Sh.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe se e njëjta duhet të refuzohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo ngase në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, është vërtetuar se e paditura Spitali i Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit B.Sh. për pezullimin e përkohshëm të punës, ka vepruar bazuar në dispozitat ligjore, përkatësisht konform nenit 22, të Ligjit për Zyrtarët Publik, Nr.06/L-114, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi ka kërkuar pezullimin e procedurës, sipas të cilit është përcaktuar se në cilat raste mund të bëhet pezullimi i përkohshëm i marrëdhënies së punës. Përkatësisht bazuar në paragrafin 1, të këtij neni, është paraparë se: "Zyrtarët publikë, të cilët kandidojnë për zgjedhjet qendrore ose lokale, duhet të pezullojnë vendin e punës shtatë (7) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës. Pezullimi përfundon pesë (5) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës", si dhe bazuar në paragrafin 6, në të cilin është paraparë se: "Në rast të zgjedhjes në Kuvendin e Republikës së Kosovës, zyrtari publik, i cili pranon mandatin, pezullon marrëdhënien e punës prej datës së certifikimit të zgjedhjes së kandidatit deri në përfundim të mandatit përkatës, në pozitë ekuivalente", si dhe bazuar në shkresat e lëndës, gjykata vlerësoi se e paditura ka vepruar drejtë në rastin kur paditësit nuk i është njohur e drejta për pezullimin e vendit të punës, pasi që i njëjti nuk ka qenë kandidatë për zgjedhje qendrore ose lokale, përkatësisht i njëjti nuk është zgjedhur në Kuvendin e Republikës së Kosovës, apo në Organet Komunale. Bazuar në shkresat e lëndës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.Sh. është emëruar Kryeshf Ekzekutiv, në Ndërmarrjen Publike Kompania Regionale e Mbeturinave "Ekoregjioni" Sh.A, në Prizren, për një periudhë tre vjeçare, dhe atë konform dispozitave ligjore të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ashtu që në këtë rast nuk aplikohen dispozitat e nenit 22 të Ligjit për Zyrtarët Publik.



Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të autorizuarit të paditësit, se këtu paditësit i janë shkelur të drejtat të cilat rrjedhin nga neni 41 te Ligjit të Punës, e se rastin konkret është bërë interpretim i gabuar të drejtës materiale, ngase vendimi është bazuar ne nenin 22 të Ligjit për Zyrtarët Publik, ngase si funksionarë publikë janë edhe personat qe mbajnë pozita të tjera përveç pozitive politike siç është rasti i paditësit, të cilat pretendime i vlerësoi si të pabazuara, pasi që për gjykatën nuk është kontestuese se paditësi ka qenë zyrtarë publik në pozitën e tij si Zyrtarë Ligjorë pranë të paditurës, mirëpo kontestuese ka qenë se a ka të drejtë që paditësi të kërkoj pezullimin e përkohshëm të punës, për shkak të zgjedhjes së tij si Kryeshef Ekzekutiv pranë një Ndërmarrje Private.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjygjëse dhe provat materiale të administruara në shqyrtimin kryesor (leximi i vendimit me nr. 20, të datës 28.01.2021, të nxjerr nga Oda Ekonomike e Kosovës për B.F. nga Gjakova), por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Për pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi konform nenit 450 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, pasi që pala e paditur nuk i kërkoj të njëjtat.

Nga të lartcekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.151/2023, datë 18 mars 2024**

**G j y q t a r i**  
**Shyqri Hoxha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.